



## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### Regjistrimi i Partisë: “Crnogorska Demokratska Stranka –CDS” (Partia Demokratike Malaziasë) - i hapur për shqyrtim publik

**Prishtinë, 26 qershor 2009** – “Partia Demokratike Malaziasë” me akronim CDS, sot ka kompletuar kërkesat për regjistrim, të parashtruara nga Zyra për Regjistrim të Partive Politike pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Vendimi përfundimtar për regjistrim të iniciativës politike do të merret pas përfundimit të periudhës shtatë (7) ditore, gjatë të cilës publiku mund ti shqyrtoj dokumentet e regjistrimit.

“CDS” është themeluar më 11 qershor 2009 nga z. Slobodan Vujicic dhe sipas programit të saj angazhohet për jetë më të mirë, tolerancë, për barazinë dhe lirinë qytetare, për ruajtjen e identitetit nacional, besimit, kultures, gjuhes dhe integritetit të Kosovës në Evropë. Është e përcaktuar për integritet evropatlantike si dhe në të gjitha organizmat dhe institucionet ndërkombetare. “CDS” angazhohet për barazime gjinore, mbrojtjen shëndetësore të qytetarëve, për zhvillim dhe përpunime të sportit dhe punësim të rinisë.

Zyrës për Regjistrim të Partive Politike i është dhënë përgjegjësi për regjistrimin e partive politike në Kosovë, nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.

Sipas Rregulles së KQZ-së nr.01/2008 për “Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike në Kosovë” Secili mund ta kundërshtojë kërkesën në bazë të një ose më shumë arsyeve të parashtruara në nenin 5 me dorëzimin e kundërshtimeve me shkrim në Zyrë së bashku me çfardo të dhëne apo material që mbështetë kundërshtimet brenda shtatë (7) ditëve nga shpallja e kërkesës.

Të gjitha materialet e regjistrimit duke përfshirë programin e partisë, statutin, dhe shenjë do të jenë në dispozicion për shikim dhe komente nga publiku.

Promovimi i transparencës për procesin e regjistrimit të partive politike është pjesë e procesit të KQZ-së.

Zyra për Regjistrim të Partive Politike gjendet në Rr. Agim Ramadani p.n në Prishtinë. Secili që dëshiron ti shikojë dokumentet mund të vijë në Zyrë prej orës 10-12 gjatë ditëve të rregullta të punës, nga data 26 qershor deri më 2 korrik 2009. Për informatë shtesë mund të kontaktoni Zyren për Regjistrim të Partive Politike / Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, +381 (0)38 20023004.